



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
KABINETI

U R D H E R

Nr. 3, Datë 10.1.2012

Për

shpalljen e ndryshimeve të disa Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të ndodhura gjatë viteve 2010-2011.

Në mbështetje të nenit nr. 4, pika 3, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, i ndryshuar, të VKM nr. 672, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendëshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe sipas Vendimit nr.4, datë 26.12.2011 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit,

U R D H E R O J

1. Shpalljen për zbatim të ndryshimeve në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në standartet ndërkombëtare të raportimit financiar, të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit gjatë viteve 2010 e 2011, dhe të përkthyer nga gjuha angleze nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si më poshtë:
 - Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit nr. 27 “Pasqyrat Financiare individuale”.
 - Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit nr. 28 “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta”
 - Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar nr. 9 “Instrumentat financiarë”
2. Njësitë ekonomike, të cilat sipas parashikimeve të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar” janë të detyruara të zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar, të aplikojnë ndryshimet si në pikën 1 të këtij Urdhëri, duke filluar nga data 1 janar 2013.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe në atë të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Ridvan BODE

MINISTER